



## Kush vendos ?

Zyra e të huajve (OE)



Zyra e të Huajve administron hyrjen në territorin belg. Zyra shqyrton dosjet me qëllim që një vendim të mirret për dhënien ose jo të qëndrimit, vetëm për kërkesën e azilit (ai merr kërkesën dhe ia transmeton Komisarariatit të Përgjithshëm të Refugjatëve dhe të Apatridave). Në të gjitha rastet, është zyra që jep, që zgjat ose heq të drejtën e qëndrimit, vetëm disa dokumenta të lëshuara nga CGRA personave të njohur refugjatë (çertifikata e lindjes, e martesës, çertifikata e njohjes të statusit). Është gjithashtu zyra që vendos për masat e largimit (kthimi në vend).



## Komisariati i Përgjithshëm i Refugjatëve dhe i Apatridave (CGRA)

CGRA është instanca që kujdeset për refugjatët në Belgjik : ai është i vetmi që merr një vendim mbi statusin e refugjatit ose mbrojtjes dytësore (shtesë). CGRA dërgon ftesë kërkuarit të azilit i cili mund të jetë i shoqëruar nga avokati i tij ose nga një person i besueshëm. Kujdes, këshilla profesionale e një avokati është shumë e këshilluar.





CGRA verifikon nëse kërkuesi i azilit hyn në kriteret e azilit (frika e persekutimit personal për arsye race, feje, nënshtetësie , opinjoneve politike , ose përkatësia e një grupi social të veçantë), ose nga mbrojtësja dytësore (shtesë)(personat që vijnë nga një vend që është në luftë, që mund të kenë trajtime ç'njerëzore në vendin e tyre, ...). Në rastin e një vendimi negativ një ankese (recours) mund të bëhet pranë Këshillit të Mosmarrëveshjeve të Huajve (CCE).

## Këshilli i Mosmarrëveshjeve të Huajve (CCE)

CCE është instanca juridike e pavarur që shqyrton ankesat. Një vendim negativ i CGRA -së ose I OE mund të bëjë qëllimin e një ankese. Procedura është me shkrim ndërhyrja e një avokati është e domosdoshme sepse ankesa i nënshtrohet disa rregullave të rrepta. Sipas rasteve, kjo ankesa do të jetë në pezullin (vendimi është <<pezulluar>> në pritje të vendimit të CCE) ose jo (Urdhëri për Largimin nga Territori është dhënë pas pritur përgjigjjen e CCE).

## Këshilli i Shtetit

Eshtë instanca juridike që verifikon vetëm nëse procedura është trajtuar në mënyrë të pagabuar ; ajo nuk mund të marrë vendim në thelb. Pra në këtë shkallë nuk bëhet fjalë të tregoni historinë tuaj ose të jepni argumenta të reja .

Avikati paraqitet vetëm para kësaj instance mbasi e ka plotësuar dosjen. Në fillim, Këshilli i Shtetit jep shpejt një vendim mbi pranueshmërinë e kërkesës dhe pastaj shqyrton dosjen. Ai mund të anulojë ose të pezullojë vendimin e fundit që është dhënë.

Një ankesë në Këshillin e Shtetit nuk është asnjëherë në pezullim. Urdhëri për Largimin nga Territori qëndron në aplikim.



E dreta për qëndrim është një lëndë e ndërlikuar, kryesisht e administruar nga ligji i 15 Dhjetorit 1980 për hyrjen në territor, qëndrimin, rregullimin dhe largimin e të huajve. Ne ju paraqesim këtu me linja të mëdhaja sepse **procedurat kanë nevojë për ndërhyrjen e një avokati të specializuar**<sup>2</sup>.



Avokati është një jurist që ka studiuar Drejtësinë. Ai është një person i besueshëm që më dëgjon, më këshillon dhe më përfaqëson gjatë gjithë procedurës. Ai mundet të më përfaqësojë gjatë audiencave të mija dhe të mbrojë interesat e mija. Ai është i detyruar të mbrojë sekretin profesional : pra unë mundem ti flas atij pa frikë.

Në qoftëse nuk njoh avokat, unë mundem të shkoj tek Shtëpia e Drejtësisë ose tek Byroja e Ndihmës Juridike. Avokatët janë aty dhe u përgjigjen pyetjeve të përgjithshme dhe ju orientojnë drejt shërbimeve përkatëse.

Unë mundem të kërkoj caktimin e një avokati.



<sup>2</sup> Qendrat Krahinore për Integrimin dhe disa shoqata propozojnë një këshillë juridike falas.



## Kërkesa e azilit dhe mbrojtja dytësore (shtesë)

Konventa e Gjenevës parashikon mbrojtjen e të gjithë atyre personave që janë të kërcënuar personalisht për arsye politike, race, feje, nënshtetësie ose përkatësia e një grupi social. Kërkesa është bërë në kufi ose tek Zyra e të Huajve brenda 8 ditëve të ardhjes (ose para afatit të qëndrimit, nëse bëhet fjalë për një qëndrim të gjatë): dosja plotësohet dhe transmetohet Komisarariatit të Përgjithshëm të Refugjatëve dhe i Apatridave (CGRA ), që pret personin, shqyrton provat e kërcënimit dhe vendos për dhënien e statusit të refugjatit. CGRA, shqyrton në të njëjtën kohë mundësinë e një mbrojtje <<dytësore>> (shtesë ) për të cilën, në disa raste të caktuara, provën e një kërcënimi personal mundet të zëvendësohet nga një vlerësim i një kërcënimi global të përkohshëm.

- I huaji që ka bërë një kërkesë azili mbas 31 Majit 2007 merr, mbas një kontrolli pozitiv të banesës, një vërtetim të regjistrimit (karta portokalle) e vlefshme 3 muaj, pastaj çdo muaj deri kur të marrë vendimin përfundimtar. Në rastin e një vendimi negativ të CGRA, një ankesë mund të bëhet pranë Këshillit të Mosmarrëveshjeve të Huajve (CCE) : kjo ankesë është pezulluese.
- Nëse ai është i njohur refugjat, ai merrnjë CIRE<sup>3</sup> të pakufizuar (kartë B). Në qoftëse është një mbrojtje dytësore (shtesë), ai merr një CIRE të kufizuar për një vit (kartë A), me zgjatje dhe që mund të përsëritet. Mbas 5 vitesh, e drejta për qëndrim bëhet e pakufizuar.

## Kërkesa e rregullimit për arsye njerëzore (9 bis)

Të gjitha kërkesat me leje qëndrimi më shumë se tre muaj duhet të bëhen në shtetin e origjinës, pranë postit diplomatik ose tek konsulli belg. 9bis-i është pra një përjashtim i rregullës : një i huaj tashmë i pranishëm në territor, nëse ai ka një pasaportë, mundet, për rrethana të jashtëzakonshme, të bëjë një kërkesë për rregullim pranë Administratës Komunale, që ia transmeton Zyrës të Huajve. Megjithatë, gjatë kohës që ai nuk ka marrë përgjigje pozitive kërkesës së tij, ai qëndron në situatë të parregullt, domethënë në mënyrë të paligjshme.

- Në qoftëse rregullimi është pranuar, personi merr një CIRE të kufizuar për një vit që përsëritet me disa kushte (kartë A) ose një qëndrim përfundimtar.

<sup>3</sup> Çertifikata e Regjistrimit në Regjistrin e të Huajve.



## Kërkesa për rregullim për arsyje mjekësore (9 ter)

Kjo procedurë mund të bëhet pranë Zyrës të Huajve për një të huaj që qëndron në Belgjik, që ka një dokument identiteti dhe që vuan nga një sëmundje që rrezikon jetën e tij ose integritetin e tij fizik, një rrezik të trajtimit ç'njerëzor kur nuk egziston një trajtim i përshtatshëm në vendin e tij të origjinës.

Kërkesa duhet të dërgohet me rekomandë direct tek OE-ja.

Shqyrtimi i kërkesës bëhet në dy etapa : kur është e gjykuar e pranueshme dhe mbas një kontrolli pozitiv të banesës, personi merr një vërtetim të regjistrimit (kartë portokalle) e vlefshme 3 muaj , që përsëritet tre herë 3 muaj, pastaj çdo muaj. Pastaj, në qoftëse e drejta e qëndrimit është njohur, personi merr një një CIRE të kufizuar (kartë A) për një vit, që përsëritet. Mbas 5 vitesh, personi mundet të marrë një CIRE të pakufizuar (kartë B).

## Trafikimi i Qënieve Njerëzore

Në qoftëse personi është viktimë e trafikut të qënieve njerëzore (shfrytëzimi nga një rrjet të trafikut të organizuar ose nga çdo lloj shfrytëzimi tjetër), egziston një pritje e veçantë për këmbimin e bashkëpunimit të tij për të shkatërrimin e zinxhirit (rrjetit të trafikut). Procedura është e ndërlikuar dhe nevojitet paraqitja e një ankesë (denuncimi) pranë autoriteteve gjyqësore. Kërkesa e qëndrimit bëhet pranë byrosë MINTEH në Zyrën e të Huajve.

## Grupimi familiar

Procedura bëhet pranë postit diplomatik ose konsullit në vendin tuaj të origjinës ose, në disa raste, në Administratën Komunale.

Një i huaj, shtetas i një vendi të tretë që ka një qëndrim të pakufizuar (art 10) hap të drejtën për disa pjesëtarë të familjes (bashkëshort , partenare e regjistruar, fëmijë nën moshë, fëmijë më shumë se 21 vjeç handikap në ngarkim, prindërit e një MENA të njohur refugjatë ose që përfitojnë nga mbrojtja dytësore (shtesë )) për tu bashkuar, me kusht që të ketë prova për të ardhurat që ka, rregullisht dhe të mjaftueshme ashtu edhe për një banesë të mjaftueshme, një sigurim për sëmundjen, një certifikatë mjekësore dhe një vërtetim të regjistrimit të gjëndjes



gjyqësore të pastërt. Grupimi arrin atëherë me viza D (qëndrim të gjatë) dhe merr, mbas një kontrolli pozitiv të banesës një qëndrim të kufizuar (kartë A). Mbas 3 vitesh, personi mundet të kërkojë një qëndrim të pakufizuar (kartë B) pranë Administratës komunale, që ia transmeton Zyrës të Huajve. Në qoftëse ndodh një ndarje ose një humbje e të ardhurave gjatë 3 viteve, titulli i qëndrimit ju hiqet, përveç motiveve të jashtëzakonshme (për shembull dhuna bashkëshortore). Një ankesë pezulluese kundër këtij vendimi mund të bëhet pranë Këshillit të Mosmarrëveshjeve të Huajve (CCE).

Kushtet janë të njëjta për një grupim me një të huaj shtetas i një vendi të tretë që ka një qëndrim të kufizuar (art 10) veçse qëndrimi i kufizuar (kartë A) nuk mund të kalojë afatin e titullit të qëndrimit të personit që bën grupimin.

Një i huaj që ndodhet në Belgjik me qëndrim të ligjshëm mund ti kërkojë Komunës një ndryshim statusi : për shembull, studenti që martohet. Ai merr atëherë një vërtetim të regjistrimit (kartë portokalle) për 6 muaj, me zgjatje dy herë 3 muaj. Në qoftëse e drejta e qëndrimit është njohur, ai merr një CIRE të kufizuar (kartë A) për një vit, që përsëritet. Mbas 3 vitesh, qëndrimi mund të bëhet përfundimtar (kartë B). I huaji shtetas i një vendi të tretë që është pjesëtar i familjes të një qytetari të Bashkimit Evropian ose të Hapësirës Ekonomike Evropiane (art. 40 bis) mundet të vijë në Belgjik për një qëndrim të shkurtër për 3 muaj, me kusht që të deklarohet te Komuna brenda 10 ditëve të ardhjes së tij. Në qoftëse ai dëshiron të qëndrojë më gjatë, ai duhet të bëjë një kërkesë të autorizimit të qëndrimit në Komunën e banesës së tij para daljes së afatit të visës së tij. Në jemi atëherë në kuadrin e një grupimi familjar, i nënshtrohet disa kushteve të ardhurave, të banesës dhe të sigurimeve mjekësore. Nëse lidhja familjare është bërë, (bashkëshorti, partnerja e regjistruar, fëmija nën moshë, fëmija më shumë se 21 vjeç handikap në ngarkim të tij, prindërit e një MENA të njohur refugjatë ose që përfitojnë nga mbrojtja dytësore (shtesë)), mbas një kontrolli pozitiv të banesës, personi merr një vërtetim të regjistrimit për 6 muaj. Ai ka pastaj 3 muaj për të plotësuar dosjen e tij. Në qoftëse e drejta e qëndrimit është njohur, Komuna i jep një kartë F. Mbas 3 vitesh, qëndrimi mund të bëhet përfundimtar (kartë F+). Në rast se refuzohet, një ankesë është e mundur para Këshillit të Mosmarrëveshjeve të Huajve.

## Qëndrimi i shkurtër

I huaji shtetas i një vendi të tretë që vjen në Belgjik me viza me qëndrim të shkurtër ose që nuk ka nevojë për viza duhet të paraqitet te Komuna për të bërë një deklaratë të ardhjes. Ai merr atëherë një aneks 3 mbi të cilën është shënuar zgjatja e qëndrimit të tij.

# Lidhjet me Zyrën dhe me CGRA



Gjatë gjithë kohës së procedurës, kryesore është të komunikoni me Zyrën e të Huajve dhe / ose me CGRA të gjitha ndryshimet ose informacionet e reja që i përkasin situatës time në Belgjik. : ndryshimi i adresës, ndryshimi i përbërjes familjare (për shembull lindja e një fëmije), përsëritja e kartës time të qëndrimit...



## Ndryshimi i adresës

Zyra dhe ose CGRA duhet të jenë në dijeni në çdo moment nëse jam në territorin belg. Në qoftëse nuk jetoj më në Belgjik, dosja ime mund të mbyllet. Pra është shumë e rëndësishme t'i lajmëroni me letër për çdo ndryshim banese.



Si ? Shkruani një letër dhe e dërgoni me letër rekomande në Zyrën e të Huajve dhe, nëse është e nevojshme, në CGRA. Kjo gjë bëhet në postë : marr një dokument që vërteton që letra ime është dërguar. Kujdes, kjo letër duhet të shoqërohet me një vërtetim të Komunës që garanton ndryshimin e adresës.

## Ndryshimi i banesës të zgjedhur

Banesa e zgjedhur, është adresa në të cilën dëshiroj të marr letrat e Zyrës së Huajve dhe të CGRA. Kjo mund të jetë adresa ime personale, ajo e avokatit tim ose ajo e një personi të besueshëm. Unë marr kryesisht të gjitha ftesat dhe lajmërimet zyrtare.





Sa herë që dëshiroj të ndryshoj këtë adresë, duhet ti lajmëroj letër rekomande.

## Ndryshimi i përbërjes familjare

Përbërja familjare është një dokument administrativ i Komunës që kush jeton me mua në të njëjtën shtëpi.

Të gjitha ndryshimet duhet të sinjalohen në Zyrën e të Huajve dhe në CGRA sepse mund të ketë pasoja për procedurën time : të kesh ose të adoptosh një fëmijë, të martohesh, të jesh bashkëbanues, të divorcohesh, të humbësh një bashkëshort ose fëmijë.

## Përsëritja e kartës të qëndrimit

Kur dokumenti im i qëndrimit arrin në afat, unë duhet të shkoj në Komunë në zyrën e rezervuar për të huajt që ta përsëris (kartën), nëse është e mundur dy muaj para daljes së afatit.

Në qoftëse është një **CIRE**, ose kartë F, unë duhet ti sjell Komunës provat që kushtet e kërkuara nga Zyra e të Huajve për një përsëritje (të kartës) janë të plotësuar. Këto kushte janë të shkruajtura në dokumentin që shoqëron CIRE-n time dhe unë duhet të jem shumë i vëmendshëm në momentin e daljes së afateve. Unë vetë mundem ta transmetoj dosjen time në Komunën time të banesës që Zyra e të Huajve të ketë mundësinë të shqyrtojë këto kushte. Pra është Zyra e të Huajve që vendos dhe dërgon udhëzimet Komunës. Nëse kam nevojë ose kushtet që duhen plotësuar janë të ndërlikuara, kaloj nëpërmjet avokatit për të dërguar të gjitha letrat që posedoj.

Në qoftëse bëhet fjalë për **vërtetimin e regjistrimit** (karta portokalle), një vulë e re duhet ti vihet për çdo tre muaj, **pastaj çdo muaj**. Në këtë rast, unë shkoj tek Administrata komunale datën e afatit për aplikimin e vulës. Për shembull: Vërtetimi im i regjistrimit është i vlefshëm deri të martën me 20 Mars. Unë jam i detyruar të përsëris (kartën) të mërkurën me 21 Mars.





Në qoftëse Komuna është e mbyllur gjatë fund javës, une duhet të shkoj të premten (një ditë më parë).

Kujdes, kur karta të mbushtet me vula, Administrata më lëshon një të re: duhet pra të sillni një fotografi të re të identitetit.

**Jam i kujdesshëm: shënoj datat për përsëritjen e titullit të qëndrimit, unë komunikoj sa më mirë provat që unë respektoj kushtet dhe unë sinjaloj menjëherë çdo ndryshim në situatën time.**

Nëse është e nevojshme, unë bëj thirrje një shërbimit të shkrimtarëve publik: Qendrat Krahinore për Intergrimin dhe disa Shoqata propozojnë një ndihmë për shkrimin falas.



## Changement de résidence

Office des Étrangers  
Chaussée d'Anvers, 59b  
1000 Bruxelles

e xx/xx/201x

Madame, Monsieur,

Concerne : Changement de ma résidence habituelle.

Mes références : Madame Gertrude Dumont, N°SP : \_\_\_\_\_ ou N°CGRA : \_\_\_\_\_

En date du \_\_\_\_\_, j'ai effectué mon changement de résidence habituelle auprès de ma Commune. Je vous transmets dès lors ma nouvelle adresse ainsi qu'une attestation de la Commune certifiant ce changement.

.....  
.....  
.....  
.....  
.....

Mme Gertrude DUMONT



## Changement de domicile élu

CGRA  
Boulevard du Roi Albert II, 26A  
Bruxelles

### Demande de changement d'élection de domicile élu

Je soussigné() .....N°SP : .....

Déclare vouloir modifier mon domicile élu.

Nouveau Domicile élu :

.....  
.....  
.....  
.....

Fait à ..... le .....

Signature :



## Office des Étrangers

World Trade Center, Tour II

Chaussée d'Anvers, 59B

1000 Bruxelles

Tél : 02/793.80.00



Email : [helpdesk.dvzoe@dofi.fgov.be](mailto:helpdesk.dvzoe@dofi.fgov.be)

## CGRA

World Trade Center II

Boulevard du Roi Albert II, 26A

1000 bruxelles

Tél : 02.205.51.11



Email : [cgra.info@ibz.fgov.be](mailto:cgra.info@ibz.fgov.be)

## CCE

Rue Gaucheret, 92-94

1030 Bruxelles

Tél : 02/791.60.00



Email : [info.rvv-cce@ibz.fgov.be](mailto:info.rvv-cce@ibz.fgov.be)

## Conseil d'État

Rue de la Sciences, 33

1040 Bruxelles.

## Haut Commissariat des Nations Unies pour les Réfugiés

Comité Belge d'Aide aux Réfugiés

Rue Defacqz, 1 bte 10

1000 Bruxelles

Tél : 02/537.82.20



[info@cbar-bchv.be](mailto:info@cbar-bchv.be)